<p>5. Autoriteti Kompetent sipas nenit 9, paragrafin 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Lidhur me vendimin e marrë, Autoriteti Kompetent njofton menjëherë me shkrim personin që ka paraqitur ankesë. Një kopje e vendimit i dorëzohet edhe Këshillit përkatës, dhe në rastet e parapara me paragrafin 2 të këtij neni edhe te Ministrit të Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit.</p>	<p>5 The Competent Authority pursuant to Article 9, paragraph 1, shall review the complaint within thirty (30) days from the day it has received the complaint and shall proceed in accordance with Article 12, paragraph 2 unless it determines that the complaint is evidently frivolous, unsubstantiated, not related to a disciplinary offence or subject to statutory limitation. The Competent Authority shall immediately inform the person who has submitted the complaint in writing of its decision. A copy of the decision shall also be submitted to the respective Council, and in cases provided for in paragraph 2 to this Article, aslo to the Minister of Justice, and the Ombudsperson.</p>	<p>5. Nadležni organ u skladu sa članom 9. stav 1., razmotri žalbu u roku od trideset (30) dana od dana prijema žalbe i postupa u skladu sa članom 12, stav 2, osim u slučaju kada utvrdi da je tužba očigledno neozbiljna, neosnovana, ne da se bavi bilo kojim disciplinskim prekršajem ili je propisan. Što se tiče donošenja odluke, nadležni organ će odmah obavijestiti lice koje je podnelo žalbu. Kopija odluke se dostavlja i odgovarajućem Savetu, i onda kada je isto predviđeno paragraf.2 ovog člana, Ministru pravde i Ombudsmanu.</p>
<p>6. Nëse Kryetari i Gjykatës ose Kryeprokurori nuk shqyrton dhe nuk vendos lidhur me ankesën ose nuk njofton personin që ka paraqitur ankesë për arsyt e</p>	<p>6. Failure by a Court President or the Chief State Prosecutor to review and decide on the complaint or to inform the person who has submitted a complaint of the reasons for the</p>	<p>6. Ukoliko predsednik suda ili tužilac ne uzima u obzir i ne odlučuje o žalbi ili ne obavesti osobu koja je podnela žalbu o razlozima za odbacivanje žalbe, kao što se</p>

<p>hedhjes poshtë të ankesës, siç kërkohet në paragrafin 5, konsiderohet se kanë kryer shkelje disiplinore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Parashkrimi</p> <p>Autoriteti Kompetent nuk kërkon fillimin e hetimeve si dhe Këshilli nuk fillon hetimet ndaj një gjyqtari apo prokurori për shkelje disiplinore në qoftë se kanë kaluar pesë (5) vjet nga koha e kryerjes së shkeljes së supozuar disiplinore, përveç nëse shkelja disiplinore konstituon vepër penale. Në rast të tillë, do të aplikohen dispozitat e Kodit Penal në lidhje me parashkrimin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Vepra penale</p> <p>1. Në rastet kur shkelja e supozuar disiplinore përmban elemente të veprës penale, Autoriteti Kompetent sipas detyrës zyrtare ia referon çështjen Prokurorit të Shtetit si dhe e njofton Këshillin, Ministrin e Drejtësisë, dhe Avokatin e Popullit.</p>	<p>dismissal of the complaint as required in paragraph 5 shall be a disciplinary offense.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Statutory limitation</p> <p>A Competent Authority shall not request the initiation of investigations, and the Council shall not initiate investigations against a judge or prosecutor for disciplinary offenses if five (5) years have passed from the time that the alleged disciplinary offense has been committed, except if the offense, unless the disciplinary offence constitutes criminal offence. In that case, the provisions of the Criminal Code in relation to the statutory limitations shall be applicable.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Criminal offense</p> <p>1. In cases when the alleged disciplinary offense contains elements of a criminal offense, the Competent Authority shall <i>ex-officio</i> refer the case to the State Prosecutor and provide written notification thereof to the Council, the President, the Minister of Justice, and the Ombudsperson.</p>	<p>zahteva u stavu 5. smatraće se da je počinio disciplinski prekršaj.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Zastarelost predmeta</p> <p>Nadležni organ ne zahteva pokretanje istrage, a Savet ne pokreće istragu protiv sudije ili tužioca za disciplinski prekršaj, ako je proteklo pet (5) godina od početka navodnog disciplinskog prekršaja, osim onda kada disciplinski prekršaj predstavlja krivično delo. U takvom slučaju primeniće se odredbe Krivičnog kodeksa u vezi zastare.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Krivično delo</p> <p>1. Kada navodni disciplinski prekršaj sadrži elemente krivičnog dela, nadležni organ po službenoj dužnosti upućuje ovo državnom tužiocu i obaveštava Savet, ministra pravde i narodnog advokata.</p>
--	---	---

<p>2. Në rastet kur Prokurori i Shtetit vendos të mos ndjekë penalisht shkeljen, ai duhet të informojë me shkrim Autoritetin Kompetent lidhur me vendimin, i cili më pas vepron në përputhje me nenin 9, paragrafi 5, të këtij ligji.</p> <p>3. Referimi i çështjes tek Prokurori i Shtetit e ndërpret parashkrimin dhe e suspendon procedurën disiplinore.</p> <p>4. Në qoftë se referimi i çështjes tek Prokurori i Shtetit rezulton në dënim penal apo lirim nga akuza, Prokurori i Shtetit e njofton me shkrim Autoritetin Kompetent mbi rezultatin e procedurës penale, dhe Autoriteti Kompetent vepron në përputhje me nenin 9 të këtij Ligji, në qoftë se rasti disiplinor apo rasti penal përmban elemente të shkeljes disiplinore.</p>	<p>2. If the State Prosecutor decides not to prosecute the offence, he or she shall inform the Competent Authority in writing of the decision. The Competent Authority shall then proceed in accordance with Article 9, paragraph 5 of this law.</p> <p>3. Referral of the case to the State Prosecutor shall interrupt the statute of limitation and suspend the disciplinary proceedings.</p> <p>4. If the referral of the case to the State Prosecutor results in a criminal conviction or acquittal, the State Prosecutor shall inform the Competent Authority in writing on the outcome of the criminal proceedings, and the Competent Authority shall proceed in accordance with Article 9 of this law if the disciplinary case or the criminal case contains elements of a disciplinary offense.</p>	<p>2. U slučajevima kada državni tužilac odluči da ne krivичno ne goni prekršaj, o odluci koja je tada postupio u skladu sa članom 9 stav 5 ovog zakona, obaveštava nadležni organ u pisanoj formi.</p> <p>3. Podnošenje predmeta državnom tužiocu obustavlja propis i suspenduje disciplinski postupak.</p> <p>4. Ako upućivanje predmeta državnom tužiocu dovede do krivičnog dela ili oslobađajuće presude, državni tužilac pismeno obavesti nadležni organ o ishodu krivičnog postupka i nadležni organ postupi u skladu sa članom 9 ovog zakona ako disciplinski slučaj ili krivično delo sadrži elemente disciplinske povrede.</p>
<p>Neni 12 Procedura hetimore</p>	<p>Article 12 Investigation procedure</p>	<p>Član 12 Istražna procedura</p>
<p>1. Këshilli fillon procedurat disiplinore mbi bazën e kërkesës të dorëzuar në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 dhe 2 të këtij Ligji.</p> <p>2. Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi</p>	<p>1. The Council shall initiate disciplinary investigations based on a request submitted pursuant to Article 9, paragraph 1 and 2. of this law.</p> <p>2. A Competent Authority shall request the Council to initiate disciplinary investigations</p>	<p>1. Veće pokreće disciplinski postupak na osnovu zahteva podnetog u skladu sa članom 9 stav 1 i 2 ovog zakona.</p> <p>2. Nadležni organ zahteva od Saveta pokretanje disciplinske istrage na osnovu</p>

<p>bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik dhe e cila nuk është hedhur poshtë sipas nenit 9, paragrafit 5 të këtij Ligji, ose sipas detyrës zyrtare kur ka bazë të arsyeshme të besoj se një gjyqtar ose prokuror ka kryer shkelje disiplinore.</p>	<p>based on a complaint submitted by a natural or legal persons which is not dismissed according to Article 9, paragraph 5 of this law, or <i>ex-officio</i> when it has reasonable grounds to believe that a judge or a prosecutor has committed a disciplinary offence.</p>	<p>žalbe od strane fizičkog ili pravnog lica koje nije odbijena na osnovu člana 9. stav 5., ovog zakona ili po službenoj dužnosti ako postoje opravdani razlozi da se veruje da je sudija ili tužilac počinio je disciplinski prekršaj.</p>
<p>3. Ministri i Drejtësisë dhe Avokati i Popullit mund të kërkojnë nga Këshilli që të filloj hetimet disiplinore ndaj një Kryetari të Gjykatës ose Kryeprokurorit nëse kanë arsye të besojnë se ai/ajo ka kryer shkelje disiplinore sipas nenit 9, paragrafit 6 i këtij Ligji. Në rast të pranimit të ankesës Ministri i Drejtësisë dhe Avokati i Popullit gjithashtu mund të kërkojnë nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore ndaj një gjyqtari ose prokurori nëse konsiderohet se Autoriteti Kompetent ka marrë vendim për hedhjen poshtë të ankesës ndaj atij gjyqtari ose prokurori në kundërshtim me nenin 9, paragrafin 5, me ç' rast ai/ajo duhet të ofrojnë arsyetim se pse ankesa nuk duhet të ishte hedhur poshtë.</p>	<p>3. The President, the Minister of Justice, and the Ombudsperson may request the Council to initiate disciplinary investigations against a Court President or the Chief State Prosecutor if they have reasons to believe that they have committed a disciplinary offense pursuant to Article 9, paragraph 6 of this law. The President, the Minister of Justice, and the Ombudsperson may also request the Council to initiate disciplinary investigations against a judge or prosecutor if they consider that a Competent Authority has decided to dismiss a complaint against such judge or prosecutor in violation of Article 9, paragraph 5, in which case they shall provide a reasoning why the complaint should not have been dismissed.</p>	<p>3. Ministar pravde i Ombudsman može zatražiti od Saveta da pokrene disciplinske istrage protiv predsednika suda ili tuzioca ako oni imaju razloga da veruju da isti počinio disciplinski prekršaj iz člana 9. stav 6 ovog zakona. Ministar pravde i Ombudsman može da zahteva od saveta pokretanje disciplinske istrage protiv sudije ili tužioca ukoliko se smatra da je nadležni organ doneo odluku da odbije žalbu protiv tog sudije ili tužioca u suprotnosti sa članom 9. stav 5, gde treba da daju objašnjenje zašto žalba ne bi smela biti odbačena.</p>
<p>4. Kërkesa për fillimin e hetimeve disiplinore i paraqitet me shkrim Këshillit dhe gjyqtarit ose prokurorit i cili është subjekt i hetimit. Kërkesa duhet të përmbaj identitetin e gjyqtarit ose prokurorit që do të</p>	<p>4. The request to initiate disciplinary investigations shall be submitted in writing to the Council and to the judge or prosecutor who is the subject of investigation. The request shall state the identity of the judge or</p>	<p>4. Zahtev za pokretanje disciplinskih istraga podnosi se u pisanom obliku Savetu i sudiji ili tužiocu koji je predmet istrage. Zahtev treba da sadrži identitet sudije ili tužioca za istragu, tačan opis činjeničnih i pravnih</p>

<p>hetohet, një përshkrim të saktë të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore, si dhe një propozim për masën disiplinore për tu shqiptuar nga Këshilli. Këshilli krijon dhe mirëmban një bazë elektronike të të dhënave ku regjistrohen të gjitha ankesat dhe kërkesat për fillimin e hetimeve disiplinore dhe të dhënat e dorëzuara nga autoriteti kompetent. Secili rast regjistrohet në ditën kur është pranuar ankesa apo kërkesa nga Këshilli.</p> <p>5. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga marrja e kërkesës për fillimin e hetimeve disiplinore, Këshilli themelon një panel hetimor për kryerjen e hetimeve. Në rastet e parashtruara në paragrafin 3 të këtij neni, Këshilli mund të hedh poshtë kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë apo të Avokatit të Popullit pa formuar panelin hetues, në qoftë se konsideron që është prima facie pa vlerë apo rëndësi serioze, jo substanciale, nuk ka lidhje me shkeljen disiplinore apo është parashkruar. Paneli hetimor, për sa i përket një gjyqtari, përbëhet nga tre gjyqtarë të një gjykate tjetër. Paneli hetimor, për sa i përket një prokurori, përbëhet nga tre prokurorë të një organi tjetër prokurorial. Këshilli përcakton kryesuesin e panelit hetimor nga</p>	<p>prosecutor who shall be investigated, a concise description of the factual and legal aspects which give rise to the allegation for a disciplinary offense and a proposal for a disciplinary sanction to be imposed by the Council. The Council shall establish and maintain an electronic database, which will register all complaints and requests for initiating disciplinary investigations and information submitted by competent authority. Each case will be registered within the same day that the complaint or request was received by the Council.</p> <p>5. Within ten (10) working days from the receipt of a request to initiate disciplinary investigations, the Council shall establish an investigation panel to conduct the investigation. In cases foreseen within the paragraph 3 of this article, the Council may dismiss the request of the Minister of Justice or the Ombudsman without forming the investigating panel, if it is considered prima facie that it is not of a serious importance or has no value, it is not substantial and it does not have any kind of a relation with the disciplinary offence or falls under the status of limitations. The investigation panel concerning a judge shall be composed of three judges from a different court. The investigation panel concerning a prosecutor</p>	<p>aspekata na koje je podignuta sumnja na disciplinsku povredu, kao i predlog za disciplinsku meru koju nametne Savet. Savet uspostavlja i vodi elektronsku bazu podataka u kojoj se evidentiraju sve pritužbe i zahtevi za pokretanje disciplinskih istraga i podaci podnetih od strane nadležnog organa. Svaki slučaj se registruje na dan kada je Savet primio žalbu ili zahtev.</p> <p>5. U roku od deset (10) radnih dana od prijema zahteva za pokretanje disciplinske istrage, Savet će ustanoviti komisiju za istragu za sprovođenje istrage. U slučajevima predviđenim paragrafom 3 ovog člana, Savet može odbiti žalbu Ministra Pravde ili Ombudsmana pre formiranja istražnog panela, onda kada je prima facie jasno da žalba nema ozbiljnu važnost, nije ni od kakve vrednosti, nije sadržajna i nije ni u kakvoj vezi sa disciplinskim prekršajem, ili je zastarela. Veće, što se tiče sudije, sastoji se od tri sudije drugog suda. Istražni odbor, što se tiče tužioca, sastoji se od tri tužitelja drugog tužilačkog tela. Savet određuje predsednika istražnog veća od članova istražnog veća.</p>
---	--	--

<p>radhët e anëtarëve të panelit hetimor. Procedura për përzgjedhjen dhe caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të shërbyer në panel hetimor përcaktohet nga Këshillat. Këshilli siguron ndihmë administrative dhe profesionale për panelin hetimor.</p> <p>6. Paneli hetimor duhet të sigurojë fakte dhe të mbledh prova lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore. Gjyqtari ose prokurori nën hetime dhe autoriteti që ka kërkuar fillimin e procedurave hetimore mund të sugjerojnë dëshmitarë, të paraqesin prova, si dhe të kërkojnë paraqitjen e dokumenteve dhe provave në dispozicion të personave ose institucioneve tjera.</p> <p>7. Paneli hetimor i ofron gjyqtarit ose prokurorit mundësi për t'u dëgjuar në lidhje me ankesën dhe për t'u përfaqësuar nga avokati mbrojtës. Gjyqtari ose prokurori që është nën hetime duhet të ketë qasje në provat e mbledhura nga paneli hetimor.</p>	<p>shall be composed of three prosecutors from a different prosecution body. The Council shall determine the chairperson of the investigation panel from among the members of the investigation panel. The procedure for the selection and assignment of judges and prosecutors to serve on the investigation panel shall be determined by the Councils. The Council shall provide administrative and professional assistance to the investigation panel.</p> <p>6. The investigation panel shall establish the facts and collect evidence related to the alleged disciplinary offense. The judge or prosecutor under investigation and the authority which has requested the initiation of investigation procedures may suggest witnesses, submit evidence, as well as request the submission of documents and the evidence held by other persons or institutions.</p> <p>7. The investigation panel shall give the judge or prosecutor an effective opportunity to be heard in respect of the complaint and to be represented by defense counsel. The judge or prosecutor under investigation shall have access to all evidence collected by the investigation panel.</p>	<p>Postupak izbora i dodeljivanja sudija i tužilaca koji služe u istražnom veću određuju Saveti. Veće pruža administrativnu i stručnu pomoć istražnom veću.</p> <p>6. Istražni odbor mora dostaviti dokaze i prikupiti dokaze o navodnom disciplinskom prekršaju. Sudija ili tužilac pod istragom i vlasti traži pokretanje istražnih postupaka može predložiti svedoke, izvodi dokaze, i zahtevaju proizvodnju dokumenata i dokaza na raspolaganju drugim osobama ili institucijama.</p> <p>7. Istražni odbor pruža sudiji ili tužiocu mogućnost da se sasluša o pritužbi i da ga zastupa advokat odbrane. Sudija ili tužilac koji je pod istragom treba da ima pristup dokazima koje prikuplja istražni odbor.</p>
---	---	--

<p>8. Paneli hetimor duhet t'i përfundoj hetimet brenda tre (3) muajve nga dita kur është themeluar nga Këshilli. Në rrethana të jashtëzakonshme, Këshilli mund t'i zgjasë hetimet për një periudhë shtesë deri në dy (2) muaj. Me t'i përfunduar hetimet, paneli hetimor duhet të paraqesë tek Këshilli Komisioni, gjyqtari apo prokurori që është nën hetime, dhe tek Autoriteti Kompetent që ka kërkuar fillimin e hetimeve disiplinore, një raport me shkrim mbi të gjitha faktet dhe provat e mbledhura. Pas dorëzimit të raportit paneli hetimor pushon funksionin e vet.</p>	<p>8. The investigation panel shall complete the investigation within three (3) months from the day it was established by the Council. In exceptional circumstances, the Council may extend the investigation for an additional period of up to two (2) months. Upon completion of the investigation, the investigation panel shall submit to the Council, the judge or prosecutor under investigation and the Competent Authority which has requested the initiation of disciplinary investigations a written report on all collected facts and evidence. The investigation panel shall cease its function upon submission of the report.</p>	<p>8. Istražno veće će završiti istrage u roku od tri (3) meseca od dana kada ga je ustanovio Savet. U izuzetnim okolnostima, Savet može produžiti istragu za dodatni period do dva (2) meseca. Prilikom završavanja istrage, veće za istragu dostavlja Savetu, sudija ili tužilac koji je pod istragom, a da nadležni organ je zatražila pokretanje disciplinske istrage, pismeni izveštaj o svim činjenicama i dokazima prikupljenim. Nakon podnošenja izvještaja, istražni odbor prekida svoju funkciju.</p>
<p>9. Gjatë procedurës hetimore, Këshilli <i>ex officio</i> ose me kërkesë të Autoritetit Kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve, mund të pezulloj gjyqtarin ose prokurorin i cili është nën hetime nëse një gjë e tillë është e nevojshme duke marrë parasysh seriozitetin e veprës së pretenduar penale dhe të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve.</p>	<p>9. During the investigation procedure, the Council may <i>ex officio</i> or upon request of the Competent Authority, which has requested the initiation of investigations, suspend the judge or prosecutor who is under investigation if this is necessary considering the seriousness of the alleged disciplinary offences and to ensure the integrity and effectiveness of the investigation.</p>	<p>9. Tokom postupka istrage, Savet po službenoj dužnosti ili na zahtev nadležnog organa koji je zatražio pokretanje istrage, može suspendovati sudiju ili tužioca koji je pod istragom ako je to neophodno uzimajući u obzir ozbiljnost navodnog krivičnog dela krivično i obezbediti integritet i efikasnost istrage.</p>
<p>10. Gjatë kohëzgjatjes së pezullimit të gjyqtarit/prokurorit nga paragrafi paraprak, i njëjti do pranojë 50% e pagës mujore.</p>	<p>10. During the suspension, the judge/prosecutor shall receive 50% of the monthly salary.</p>	<p>10. Tokom perioda na koji je sudija/tužilac suspendovan, isti će primiti 50% mesečne plate.</p>
<p>11. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale</p>	<p>11. The provisions of the Criminal Procedure</p>	<p>11. Odredbe Zakona o krivičnom postupku</p>

<p>zbatohen mutatis mutandis me procedurën për mbledhjen e provave dhe të drejtat e personave nën hetime.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Marrëveshja vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore</p> <p>1. Gjatë procedurës hetimore, Këshilli dhe gjyqtari ose prokurori që është nën hetime mund të bien dakord për një marrëveshje vullnetare lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore.</p> <p>2. Marrëveshja e lidhur në mes të Këshillit dhe gjyqtarit ose prokurorit duhet të përmbajë si më poshtë:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. deklaratën faktike të shkeljes disiplinore të pranuar nga gjyqtari apo prokurori që është nën hetime;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. masën disiplinore për të cilën është rënë dakord.</p> <p>3. Marrëveshja e miratuar nga Këshilli do të ketë të njëjtin efekt ligjor sikurse vendimi i Këshillit për shkelje disiplinore.</p>	<p>Code shall apply accordingly to collection of evidence and the rights of persons under investigation.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Voluntary settlement of alleged disciplinary offense</p> <p>1. During the investigation procedure, the Council and the judge or prosecutor under investigation may agree on a voluntary settlement of the alleged disciplinary offense.</p> <p>2. The agreement entered into between the Council and the judge or prosecutor shall contain the following:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. a factual declaration of the disciplinary offense admitted by the judge or prosecutor under investigation;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. the agreed disciplinary sanction.</p> <p>3. The agreement approved by the Council shall have the same legal effect as a decision of the Council on disciplinary sanctions.</p>	<p>sprovode se u skladu sa postupkom prikupljanja dokaza i pravima lica koja se istražuju.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Dobrovoljni sporazum za navodni disciplinski prekršaj</p> <p>1. Tokom postupka istrage, Savet i sudija ili tužilac koji se nalazi pod istragom mogu se složiti oko dobrovoljnog sporazuma u vezi sa navodnim disciplinskim prekršajima.</p> <p>2. Sporazum između Saveta i sudije ili tužioca sadrži sledeće:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. činjeničnu izjavu disciplinskog prekršaja koju je primio sudija ili tužilac koji je pod istragom;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. disciplinsku meru za koju je dogovoreno.</p> <p>3. Sporazum koji je odobrio Savet ima isti pravni učinak kao i odluka Saveta o disciplinskim prekršajima.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 14 Procedurat Disiplinore</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Disciplinary Procedures</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Disciplinske Procedure</p>
<p>1. Pas pranimit të raportit me shkrim mbi hetimin e gjyqtarit apo të prokurorit, apo të pranimit të marrëveshjes bazuar në nenin 13 të këtij Ligji, Këshilli respektiv do të mbajë seancë në periudhën kohore prej katërmbëdhjetë (14) ditësh. Këshilli mund të vendos të mbajë seanca shtesë në qoftë se një gjë e tillë rrjedh nga kompleksiteti i lëndës. Palët në procedurë do të ftohen të marrin pjesë në seancat e Këshillit.</p> <p>2. Gjyqtari apo prokurori kundër të cilit zhvillohet procedura disiplinore ka të drejtë të përfaqësojë veten apo të angazhojë avokat mbrojtës. Ai apo ajo do ketë qasje në të gjitha provat e mbledhura si dhe në të gjitha dosjet e lëndës.</p> <p>3. Këshilli vendos nëse është kryer shkelja e supozuar disiplinore dhe, në rast se konstaton se gjyqtari ose prokurori ka kryer shkeljen e supozuar disiplinore, shqipton sanksionin disiplinor sipas dispozitave të këtij Ligji.</p> <p>4. Kuorumi për procedurë disiplinore do të</p>	<p>1. Upon receiving of the written report on the investigation on the judge or the prosecutor, or upon receiving of the agreement based on the article 13 of thie law, respective Council shall hold a sesion in the time frame of fourteen (14) days. The Council may choose to hold additional sessions if the necessity derives out of the complexity of the case. Parties to the procedure shall be invited to take part in the sesion of the Council.</p> <p>2. The judge or the prosecutor against who the disiplinary procedure has been initiated, has a right of defending him/herself or hire a defense lawyer. Her or she shall have access to all the evidence collected as well as in all the dossiers of the case.</p> <p>4. The Council shall decide whether the alleged disciplinary offense has been committed and, if it finds that the judge or prosecutor has committed the alleged disciplinary offense, impose the disciplinary sanction according to the provisions of this law.</p> <p>4.The quorum in disciplinary proceedings</p>	<p>1.Po prihvatu pismenog izveštaja u vezi istrage nad sudijom ili tužiocem, ili nakon prihvata sporazuma na osnovu člana 13 ovog zakona, Savet će održati ročište u periodu od četrnaest (14) dana. Savet može odlučiti da održi dodatna ročišta ako isto zahteva složenost predmeta. Stranke u proceduri će biti pazvane da prisutvuju ročištima.</p> <p>2.Sudija ili tužilac protiv koje/g se vodi istraga, ima pravo zastupati sebe ili angažovati advokata odbrane. On ili ona će imati pravo uvida u sve dokaze kao i dosije predmeta.</p> <p>3. Veće odlučuje da li ponašanje navodno disciplinski prekršaj i, ako utvrdi da je sudija ili tužilac izvršio navodni prekršaj, disciplinske kazne u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p>4.Za procedure disciplinski kvorum će se</p>

<p>përbehet nga nëntë (9) anëtarë të Këshillit, dhe vendimet e Këshillit merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve.</p> <p>5. Vendimi i Këshillit duhet të jetë në formë të shkruar dhe të përmbajë arsyet mbi vendimin dhe këshillën juridike. Një kopje e vendimit i dërgohet Autoritetit Kompetent që ka kërkuar fillimin e hetimeve dhe gjyqtarit ose prokurorit, dhe në rastet e parapara me nenin 12 par.3 të këtij ligji Ministrit të Drejtësisë apo Avokatit të Popullit. Vendimi do të publikohet në faqe të Këshillit pasi të bëhet final.</p> <p>6. Këshilli merr vendim brenda dy (2) muajve nga pranimi i raportit të panelit hetimor.</p>	<p>shall be nine (9) members of the Council, and Council's decisions shall be made by simple majority vote of the members.</p> <p>5. The decision of the Council shall be in written and shall contain the reasons for the decision and legal advice. A copy of the decision shall be sent to the Competent Authority which has requested the initiation of the investigation and to the judge or prosecutor and shall be published immediately on the web-site of the Council, as well as to the Minister of Justice and Ombudsman, in regard to the article 12 par.3 of this law. The decision shall be published in the web site of the Council when it becomes final.</p> <p>6. The Council shall reach its decision within two (2) months from the receipt of the report of the investigation panel.</p>	<p>sastojati od devet (9) članova odluka Saveta i Saveta se donose većinom glasova članova.</p> <p>5. Odluka Saveta je u pismenoj formi i sadrži razloge za donošenje odluke i pravni savet. Primerak rešenja dostavlja nadležnom organu koji je zatražio pokretanje istrage i sudije ili tužioca, a odmah objavljena u Savetu, kao i slučajevima predviđenim članom 12 par.3 ovog zakona, i Ministru Pravde kao i Ombudsmanu. Odluka se objavljuje na internet stranici Saveta nakon što postane konačna.</p> <p>6. Veće donosi odluku u roku od dva (2) mjeseca od prijema izvještaja istražnog vijeća.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Ankesa pranë Gjykatës Supreme</p> <p>1. Gjyqtari ose prokurori, Autoriteti Kompetent që ka kërkuar fillimin e procedurës hetimore, dhe në rastet e parapara me nenin 12 par.3 të këtij Ligji Ministria e Drejtësisë, dhe Avokati i</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Complaint to the Supreme Court</p> <p>1. The judge or prosecutor, the Competent Authority which has requested the initiation of investigations, the Ministry of Justice, and the Ombudsperson as per article 12 par.3 of this law, may file complaint against the</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Žalba u Vrhovnom Sudu</p> <p>1. Sudija ili tužilac, nadležni organ koji je zatražio pokretanje istrage, i u skladu sa članom 12 par.3 Ministar pravde i Ombudsman, mogu podneti žalbu protiv odluke Saveta pred Vrhovnim Sudom u</p>

<p>Popullit, mund të paraqesin ankesë ndaj vendimit të Këshillit pranë Gjykatës Supreme, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së vendimit. Gjyqtari apo prokurori, Autoriteti Kompetent apo në rastet e parapara me nenin 12 par.3 të këtij Ligji Ministri i Drejtësisë dhe Avokati i Popullit, mund të bëjnë përgjigje në ankesë brenda shtatë (7) ditëve nga dita kur pranojnë ankesën.</p> <p>2. Në rast se Këshilli nuk merr vendim në përputhje me nenin 14, paragrafin 6, gjyqtari apo prokurori dhe Autoriteti Kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve, si dhe në rastet e parapara me nenin 12 par.3 të këtij Ligji Ministri i Drejtësisë, dhe Avokati i Popullit, mund të ushtrojnë ankesë pranë Gjykatës Supreme për mosveprim nga ana e Këshillit përkatës.</p> <p>3. Ankesë mund të ushtrohet në rrethanat si në vijim:</p> <p>3.1 në rast të zbatimit të gabuar të ligjit;</p> <p>3.2 në rast të shkeljes procedurale të përcaktuar me ligj;</p> <p>3.3 në rast të një gabimi faktik të</p>	<p>decision of the Council before the Supreme Court within fifteen (15) days from the day when they received the decision. The judge or the prosecutor, the competent authority or in cases provided for by article 12 par.3 of this law Minister of Justice and the Ombudsman, may respons to the compaint in the time frame of seven (7) days upon receiving the complaint.</p> <p>2. If the Council does not issue a decision in accordance with Article 14, paragraph 6, the judge or prosecutor, the Competent Authority which has requested the initiation of investigations, and in accordance with article 12 par.3 of thie law the Minister of Justice, and the Ombudsperson may file a complaint before the Supreme Court for failure to act by the relevant Council.</p> <p>3. The complaint may be filed for the following reasons:</p> <p>3.1. erroneous application of the law;</p> <p>3.2. violation of procedures prescribed by law;</p> <p>3.3. a clear or obvious factual error that</p>	<p>roku od petnaest (15) dana od dana donošenja odluke. Sudija ili tužilac, nadležni organ ili u skladu sa članom 12 par.3 Ministar Pravde i Ombudsman, mogu proslediti odgovor na žalbu u sklopu od sedam (7) dana od dana prihvata žalbe.</p> <p>2. Ako Savet ne odluči u skladu sa članom 14. stav 6., sudija ili tužilac, nadležni organ koji je zatražio pokretanje istrage, kao i u skladu sa članom 12 par.3 ovog zakona, Ministar pravde i Ombudsman može podneti žalbu Vrhovnom sudu zbog propusta od strane relevantnog Saveta.</p> <p>3. Žalba se može podneti u sledećim okolnostima:</p> <p>3.1 u slučaju pogrešne primene zakona;</p> <p>3.2 u slučaju prekršaja utvrđene zakonom;</p> <p>3.3 u slučaju manifestne ili</p>
---	--	--

<p>qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës;</p> <p>4. Gjykata Supreme, në një trup gjykues të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kryetari i Gjykatës Supreme, brenda dyzet e pesë (45) ditëve, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën. Në rast se Kryetari i Gjykatës Supreme është subjekt i vendimit të Këshillit, atëherë zgjedhjen e anëtareve e bën gjyqtari më i moshuar i Gjykatës Supreme.</p> <p>5. Pas shqyrtimit të ankesës, Gjykata Supreme mund të konfirmojë vendimin e Këshillit, ta ndryshojë atë, apo ta kthejë në Këshill për rishqyrtim.</p> <p>6. Në rast se Gjykata Supreme vendos ta kthejë çështjen për rishqyrtim në Këshill, atëherë Këshilli vendos brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e marrjes së vendimit, sipas vendimit të Gjykatës, si dhe njofton Gjykatën me shkrim.</p> <p>7. Në rast se Gjykata Supreme nuk merr njoftim brenda dyzet e pesë (45)</p>	<p>affects substantial rights of the party if it seriously affects the fairness and integrity of the proceedings;</p> <p>4. The Supreme Court, within a trial panel composed of three members elected by the President of the Supreme Court shall, within forty-five (45) days, review and decide on the complaint. If the President of the Supreme Court is the subject of the Council's decision, then the oldest judge of the Supreme Court will elect the members.</p> <p>5. After reviewing the complaint, the Supreme Court may confirm the decision of the Council, amend it or return to the Council for review.</p> <p>6. In case the Supreme Court decides to return the case for review to the Council, then the Council shall decide within thirty (30) days from the day when the decision was received, according to the decision of the Court and notify the Court in writing of its decision.</p> <p>7. In case that the Supreme Court does not receive a notification according to</p>	<p>očigledne činjenične greške koja utiče na materijalna prava stranke ako ozbiljno utiče na nepristrasnost i integritet postupka;</p> <p>4. Vrhovni sud, u tročlanoj komisiji, koju predsednik Vrhovnog suda bira u roku od četrdeset (45) dana, razmatra i odlučuje o žalbi. Ako predsednik Vrhovnog suda podježe odluci Saveta, onda izbor članova vrši viši sudija Vrhovnog suda.</p> <p>5. Nakon razmatranja žalbe, Vrhovni sud može potvrditi odluku Saveta, dopuniti ili vratiti Savetu radi ponovnog razmatranja.</p> <p>6. Ako Vrhovni sud odluči da predmet vrati Veću na ponovno razmatranje, Savet odlučuje u roku od trideset (30) dana od dana prijema rešenja na osnovu odluke Suda i obavesti Sud u pisanoj formi.</p> <p>7. Ako Vrhovni sud u roku od (45) dana od dana povratka predmeta ne dobije obavest o</p>
---	---	--

<p>ditëve nga dita e kthimit të rastit për rishqyrtim siç parashihet në paragrafin 6, atëherë Gjykata Supreme vendos mbi rastin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.</p> <p>8. Vendimi i Gjykatës Supreme është përfundimtar.</p> <p>KAPITULLI IV - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</p> <p>Neni 16 Bartja e personelit dhe vazhdimi i emërimeve</p> <p>1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, personeli i Zyrës së Prokurorit Disiplinor do të bartet në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.</p> <p>2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, brenda tre (3) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do t'i zyrtarizojnë obligimet kontraktuese me personelin e bartur.</p>	<p>paragraph 6 within forty-five (45) days from the day when the case was returned for review, then the Supreme Court shall decide on the case within fifteen (15) days.</p> <p>8. The decision of the Supreme Court shall be final.</p> <p>CHAPTER IV - TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</p> <p>Article 16 Staff transfer and continuation of appointments</p> <p>1. Upon entry into force of this Law, the staff of the Office of the Disciplinary Counsel shall be transferred to the Kosovo Judicial Council and the Kosovo Prosecutorial Council.</p> <p>2. The Kosovo Judicial Council and the Kosovo Prosecutorial Council shall, within three (3) months from the day this law enters into force, make official the contractual obligations with the transferred staff.</p>	<p>ponovnom razmatranju kako je predviđeno stavom 6, onda Vrhovni sud odlučuje o slučaju u roku od petnaest (15) dana.</p> <p>8. Odluka Vrhovnog suda je konačna.</p> <p>POGLAVLJE IV – PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</p> <p>Član 16 Premeštaj osoblja i nastavak imenovanja</p> <p>1. Stupanjem na snagu ovog zakona, osoblje Kancelarije disciplinskog tužioca prebacuje se Sudskom savetu Kosova i Tužilačkom savetu Kosova.</p> <p>2. Sudski savet Kosova i Tužilački savet Kosova će u roku od tri (3) meseca od dana stupanja na snagu ovog zakona formalizovati ugovorne obaveze sa premeštenim osobljem.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 17 Dispozitat kalimtare</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Transitional provisions</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Član Prelazne odredbe</p>
<p>1. Këshillat miratojnë të gjitha rregulloret e parapara me këtë ligj brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.</p> <p>2. Vendimi mbi përfundimin e hetimeve dhe procedurave disiplinore të filluara para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, merret në përputhje me dispozitat e ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e fillimit të procedurës hetimore ose disiplinore, dhe duhet të përfundojnë brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p> <p>3. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, të gjitha ankesat lidhur me shkeljet e supozuara disiplinore do të shqyrtohen në pajtim me këtë ligj, përfshirë ato që pretendohet të jenë kryer para hyrjes në fuqi të këtij ligji por për të cilat me hyrjen në fuqi të këtij ligji ende nuk ka filluar procedura hetimore.</p>	<p>1. The Council shall adopt within six (6) months from the entry into force of the present law all regulations required pursuant to this Law.</p> <p>2. Investigations and disciplinary procedures which were initiated before the entry into force of this law shall be decided and completed in accordance with the provisions of the law which was in force at the time when the investigation or disciplinary procedure was initiated and shall be completed within one year from the entry into force of this Law.</p> <p>3. Upon entry into force of this law, all complaints concerning alleged disciplinary offenses shall be processed in accordance with this Law, including those which were allegedly committed before the entry into force of this Law, and which have not been subject to investigation before the entry into force of this Law.</p>	<p>1. Veće usvaja sve propise predviđene ovim zakonom u roku od šest (6) meseci od stupanja na snagu ovog zakona.</p> <p>2. Odluka o završetku istrage i disciplinskih postupaka započeta pre stupanja na snagu ovog zakona donosi se u skladu sa odredbama zakona koji je bio na snazi u vreme početka istražnog ili disciplinskog postupka i završava se u roku od jedne godine od dana stupanja na snagu na snazi ovog zakona.</p> <p>3. Nakon stupanja na snagu ovog zakona, sve žalbe u vezi sa navodnim disciplinskim prekršajima razmatraće se u skladu sa ovim zakonom, uključujući i one koji su navodno počinjeni prije stupanja na snagu ovog zakona, ali za koji, po stupanju na snagu ovog zakona još nije pokrenuo istražni postupak.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 18 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Entry into force</p> <p>This law shall enter into force fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">The President of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj zakona stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Sluzbenom Listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>
--	---	--